



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1385 prot.

Tiranë, më 8. 5. 2019

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi

DREJTORIVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE

Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE**

Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Ligjit 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM-së nr. 921 datë 29.12.2014 "Për personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

Specialist, Sektori i Mallrave të Rrezikshme, Dual Use, Trafikeve të Paligjshme, Drejtoria Antitrafik, pranë Departamentit Operativ Hetimor, Kategoria C1, Kategoria e Pagës III-b, 1 (një) vend pune

Kandidatët që do të aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të kenë shtetësi shqiptare
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre
4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim penal të formës së prerë
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit Master Profesional në Shkencat Ekonomike, Juridike, Natyrore, Politeknike.
7. Eksperiencë pune deri në 1 (një) vit
8. Të ketë njohuri të paktën të një gjuhe të huaj.

Avantazhe:

Të ketë njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

1. Të hartojë masat parandaluese për të luftuar trafikun e paligjshëm si dhe ndalimin e lëvizjes për mallrat e ndaluara dhe të kufizuara sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të përgjigjet për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë funksionale të postit, për parandalimin e trafikut të:
 - a. Armëve konvencionale, që përfshin armët e lehta, armët e rënda dhe armët sportive.
 - b. Armët e dëmtimit në masë.
 - c. Mallrat me përdorim të dyfishtë
 - d. Mbetjet e rrezikshme dhe mbetjet e tjera të:
 - Të lëndëve ozonholluese dhe të paisjeve që i përdorin ato.
 - Të specieve të egra të florës e faunës të mbrojtura, të specieve të ndryshme të ndaluara të importohen në vendin tonë dhe të specieve të modifikuara gjenetikisht.
 - Lendeve dhe barnave narkotike;
 - Substancave psikotrope;
 - Prekursorëve;
 - Kontrabandimin e migrantëve;
 - Automjeteve të vjedhura;
 - Veprave të artit;
 - Objekteve të trashëgimisë kulturore.

Zbatimin e monitorimin e masave kufizuese që lidhen me veprimtari të referuara apo të dyshuara terroriste, në mënyrë të vecantë masave të përcaktuara nga Rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB, në përputhje me procedurat përkatëse ligjore.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim
2. Curriculum Vitae
3. Fotokopje e Diplomës dhe Lista e Notave të noterizuara (*Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit*)
4. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore /dëshmi penaltiteti
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore
9. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
10. Fotokopje të librezës së punës;

11. Letër reference dhënë nga eprori direkt i pozicionit të fundit të punës
12. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e konkurimit do të zhvillohet në dy faza.

Në fazën parakualifikuese kandidatët do të vlerësohen nga dokumentacioni i paraqitur nëse plotësohen kërkesat për konkurim. Aplikantët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë do të vijojë me kandidatët e kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në:

- a) Pervojën
- b) Kualifikimin
- c) Aftësitë

Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Rezultatet e konkurimit

Lista me kandidatët fitues, do të shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 18.05.2019, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore/ Zyra e Sekretari/Protokollit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Arlind Gjokuta

